

BASHKIA KURBIN

PAKETA FISKALE
Bashkia KURBIN
2025

“Për një vetëqeverisje efikase dhe efçente, që synon të realizojë funksionet dhe përgjegjësitë e saj administrative në dobi të komunitetit”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5827 Prot

Laç më 03/12/2024

V E N D I M

Nr. 55 Datë 27/11/2024

PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, LEHTËSIRAT
FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE SI DHE VENDOSJES SË PENALITETEVE
NDAJ KUNDRAVAJTËSVE

Mbështetur në:

Ligjin nr.139/2015 dt.17.12.2015 "Për Vetëqeverisjes Vendore", neni 9, pika1/1.3, gërma "b", neni 35, pika 4, neni 54, gërma "f"; Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, neni 5, gërma "b", "c" dhe "ç", neni 7, neni 9 etj.; Ligjin nr.106/2013 "Për disa shtesa në ligjin nr.9632/2006"; Ligji nr.106/2017 "Për disa shtesa në ligjin nr.9632/2006"; Ligji nr.67 datë 21.07.2023 "Për një ndryshim dhe disa shtesa në Ligjin nr. 9632/2006 "Për sistemin e taksave vendore"; Ligjin nr.9920/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", Ligjin nr.115/2014 "Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.9975 "Për Taksat Kombëtare", i ndryshuar; Ligjin nr.9723/2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar; Ligjin nr.10465 datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr.8378 datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjin nr.10081 datë 23.02.2009 "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjin nr.10304 datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligjin nr.8450 date 24.02.1999 "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar; Ligjin Nr.10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" neni 12; Ligjin nr.10279 date 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative";, Ligjin nr.152/2015 datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri

dhe shpëtimi”; Ligjin 57/2020 “Për Pyjet”; Ligjin nr.8438 datë.28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me Ligjin nr. 106/2020 datë 29.07.2020 i ndryshuar me Ligjin nr.29 datë 30.03.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”;

VKM nr.132 datë 07.03.2018 “Për Metodologjinë për Përcaktimin e Vlerës së Taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme “Ndërtesa”, e Bazës së Taksës për Kategori Specifike, Natyrën dhe Prioritetin e Informacionit dhe të Dhënave për Përcaktimin e Bazës së Taksës, si dhe të Kritereve dhe Rregullave për Vlerësimin Alternativ të Detyrimit të Taksës”, të ndryshuar; V.K.M 168 datë 27.03.2019 «Për disa ndryshime në V.K.M nr.132/2018, të ndryshuar”; V.K.Mnr.144 datë 13.02.2020 “Për disa ndryshime në V.K.M nr.132/2018, të ndryshuar”; V.K.M nr. 457 datë 26.07.2023 “Për disa ndryshime në V.K.M nr.132/2018 “Për Metodologjinë për Përcaktimin e Vlerës së Taksueshme të Pasurisë së Paluajtshme “Ndërtesa”, e Bazës së Taksës për Kategori Specifike, Natyrën dhe Prioritetin e Informacionit dhe të Dhënave për Përcaktimin e Bazës së Taksës, si dhe të Kritereve dhe Rregullave për Vlerësimin Alternativ të Detyrimit të Taksës”, të ndryshuar”; V.K.M nr. 7 datë 04.12.2012 “Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare” i ndryshuar; V.K.M nr.970 datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licensave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr.344 dt.19.04.2017; V.K.M nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e proedurën e mbledhjes së tyre”; V.K.M nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, V.K.M. nr.632, datë 11/06/2009 “Për tarifat në sektorin e Kullotave” të ndryshuar; V.K.M nr.54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” i ndryshuar me V.K.M nr.992 datë 09.12.2015 dhe VKM nr. 672 datë 02.09.2020; V.K.M Nr. 469, datë 3.6.2015 “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore” ;

Udhëzimin nr.5627 datë 18.11.2016 ” Për përcaktimin e kritereve rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar; Udhëzim i Ministrit të Financave nr.1, datë 12.1.2007 “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”; Udhëzim i MF nr.32. datë.31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e Biznesit të Vogël” i ndryshuar; Udhëzim i përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri drejtësisë) nr.655/1 dt.06.02.2007 “ Për përcaktimin e uniformitetit të standarteve procedurale dhe te raportimit të

sistemit të taksës vendore”; Udhëzimin nr.6756 datë 03.09.2015 “Për zbatimin e V.K.M-së nr.54 datë 05.02.2014” i ndryshuar; Udhëzimin nr.26 datë 08.09.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, legjislacionit të aplikueshëm në fuqi , akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara, Këshilli i Bashkisë Kurbin pasi shqyrtoi projekt-paketën e propozuar nga Kryetaria e Bashkisë:

V E N D O S I

Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre si më poshtë :

- I. Për efekt të diferencimit në ofrimin e cilësisë së shërbimeve , me qëllim bashkërendimin e tyre me nivelin e aplikimit të taksave dhe tarifave vendore , të bëjë ndarjen administrative territoriale të Bashkisë Kurbin në zonat si më poshtë:
 - a. Nj/A Laç
 - b. Nj/A Mamurras
 - c. Nj/A Milot
 - d. NJ/A Fushë-Kuqe
- II. Të lidhë marrëveshje me përcaktim si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi “Ndërtesat për qëllime banimi” dhe tarifën për “Shërbimet Publike”, ndaj kategorisë së taksapaguesve si “Familjarë”, Shoqërinë Rajonale të Ujësjiellës-Kanalizimeve Lezhë, Dega Laç-Kurbin për ato familje që kanë kontratë të lidhur për furnizimin me ujë. Ndërsa familjet që nuk kanë kontratë me këtë ndërmarrje, duhet ta shlyejnë detyrimin pranë Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave në Bashkinë Kurbin apo njërive administrative përkatëse.
- III. Të miratojë për të gjithë kategoritë e taksapaguesve dhe përfituesve të shërbimeve publike të ofruara në territorin brenda juridiksionit të Bashkisë Kurbin , nivelin e taksave dhe tarifave vendore, afatet e pagesës, përjashtimet e lehtësirat fiskale për çdo zë sipas kategorive përfituese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre, të drejtën e ankimimit për çdo vlerësim, arsyen e vendosjes së penaliteteve , gjobave, për kundravajtjet e shkaktuara nga tatimpaguesi, nivelin e tyre për çdo kundravajtje, si dhe strukturat e ngarkuara për vendosjen e vjeljen e tyre.

2014
300
31
—
—

←

Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, për taksapaguesit e biznesit, institucionet, individët dhe familjet përlllogariten duke filluar nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të çdo viti.

KAPITULLI I : TAKSAT VENDORE

Në zërin ‘Taksa Vendore’ në zbatim të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 ‘Për Sistemin e Taksave Vendore’, i ndryshuar përfshin : llojin, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, si më poshtë :

1.Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme :

1.a. Taksa mbi Ndërtesat

1.b. Taksa mbi Tokën Bujqësore

1.c. Taksa mbi Truallin

2. Taksa e fjetjes në hotel

3. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

4. Taksa e tabelës

5.Taksa të përkohshme

I.1 Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive ose përdorues të saj në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.

Detyrimin për taksën mbi pasuritë e paluajtshme e ka sipas rastit, pronari ose bashkëpronari sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokument pronësie. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:

I.1.1 Taksa mbi ndërtesën.

I.1.2 Taksa mbi tokën bujqësore.

I.1.3 Taksa mbi truallin.

Ligji Nr.181/2013 neni 3 pika 3 në ndryshim të ligjit 9632/2006 thekson: Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat rajonale të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme u ofrojnë bashkive dhe komunave të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë.”.

Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë ose përdorimit.

Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme-ndërtesa.

Këshilli Bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikur sipas tabelave më poshtë, në kufijtë plus, minus 30 përqind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

Këshilli Bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

- a) Personat të cilat kanë të ardhura nën minimumin jetik sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar
- b) Taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga Këshilli Bashkiak në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind).

I. 1.1 Taksa mbi ndërtesat

a) Taksës mbi ndërtesën i nënshtrohen personat fizik ose juridik vendas apo të huaj, pronarë ose posedues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

b) Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën. Po ashtu, llogaritet si detrim vjetor i taskapaguesit.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me Vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;

- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “emri markës”;
- ë) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët ose me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jo-fitimprurëse.

Baza e taksës

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Shkalla e taksës

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0,05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

Bazuar në Ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 12 , pika 5 përcakton që për taksën e pasurisë së paluajtshme, këshilli bashkiak vendos nivelin e taksës në kufijtë plus 30 për qind dhe minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse

Përgjegjësitë e Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore

1.Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:

- a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
- b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
- c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;

ç) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;

d) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mblihdet nëpërmjet agjentëve të taksave të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me V.K.M në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave.

3. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin “Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Tabela 1. Taksa e ndërtesës sipas kategorive të Njësive Administrative Kurbin bazuar në Aneksin 1 të

V.K.M Nr.457 datë 26.07.2023

A. Taksa e ndërtesës për ambiente banimi

	Kategoritë dhe Nëndarjet për banim sipas Aneksit 1 të ligjit	Shkalla e taksës Në %	Çmimi referues në lek/m ² në Aneksin Nr.1	Vlera në lekë/m ² /vit miratuar
A.1	Njësia Administrative Laç	0.05%	42.500	21
A.2.a	Njësia Administrative Mamurras (Qendër)	0.05%	42.500	21
A.2.b	Njësia Administrative Mamurras (Fshatra)	0.05%-20%=0,040%	42.500	17
A.3	Njësia Administrative Milot	0.05%	34.000	17
A.4	Njësia Administrative Fushë-Kuqe	0.05%	34.000	17
A.5	Garazhe të mbyllura për Njësitë Administrative: Laç, Mamurras (Qendër) (70% e çmimit referues Aneksi 1)	0.05%	12.750	6
A.6	Garazhe të mbyllura për Njësitë Administrative: Mamurras (Fshatra) (70% e çmimit referues Aneksi 1)	0.05%-20%=0,040%	12.750	5
A.7	Garazhe të mbyllura për Njësitë Administrative: Milot dhe Fushë-Kuqe (70% e çmimit referues Aneksi 1)	0.05%	10.200	5

Tabela 2. Taksa e ndërtesës sipas kategorive të Njësive Administrative Kurbin bazuar në Aneksin 2 të

V.K.M Nr.457 datë 26.07.2023

Më poshtë sqarohet Aneksi 2 i V.K.M-së nr.457/2023, në lidhje me çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente jobanimi:

B. Taksa e ndërtesës për ambiente jo-banimi

	Kategoritë dhe Nëndarjet sipas Aneksit 2 të ligjit	Nj/A	Shkalla e taksës Në %	Çmimi referues në lek/m ² në Aneksin Nr.1 *1.5	Vlera në lekë/m ² /vit e miratuar
B.1.a	Njësi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi (është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas Aneksit 1) këtu përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë	Laç	0.2%	63.750	150 150
B.1.b		Mamurras	0.2%	57.375	140 140
B.1.c		Milot	0.2%	51.000	120
B.1.d		Fushë-Kuqe	0.2%	51.000	120
B.2.a	Për parkim të mbuluar dhe bodrume (është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të banesës në Aneksin 1)	Laç	0.2%	29.750	60
B.2.b		Mamurras	0.2%	29.750	60
B.2.c		Milot	0.2%	23.800	48
B.2.d		Fushë-Kuqe	0.2%	23.800	48
B.3.a	Për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbolli, minifutbolli, basketbolli, volejbolli, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të	Laç	0.2%	12.750	26
B.3.b		Mamurras	0.2%	12.750	26
B.3.c		Milot	0.2%	10.200	20

B.3.d	atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, <i>(është 30 (tridhjetë) % e çmimit të banimit)</i>	Fushë-Kuqe	0.2%	10.200	20
B.4.a	Për sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale , të tilla si:	Laç	0.2%	21.250	43
B.4.b	prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si:	Mamurras	0.2%	21.250	43
B.4.c	fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përgjatuar ato të njëjësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to <i>(është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave)</i>	Milot	0.2%	17.000	34
B.4.d		Fushë-Kuqe	0.2%	17.000	34
B.5.a	Për bujqësi dhe blegtori , apo veprimtari mbështetëse, si:	Laç	0.2%	12.750	26
B.5.b	grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, <i>(është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të banesave)</i>	Mamurras	0.2%	12.750	26
B.5.c		Milot	0.2%	10.200	20
B.5.d		Fushë-Kuqe	0.2%	10.200	20
B.6.a	Njësi ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indekssohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK	Laç	0.2%	51.000	102
B.6.b		Mamurras	0.2%	51.000	102
B.6.c		Milot	0.2%	40.800	82
B.6.d		Fushë-Kuqe	0.2%	40.800	82

C. Taksa e ndërtesave të papërfunduara

	Kategoritë dhe Nëndarjet sipas Aneksit 2 të ligjit	Shkalla e taksës Në %	Çmimi referues në lek/m ² në Aneksin Nr.1	Vlera në lekë/m ² /vit miratuar
C.1.a	Ndërtesa për qëllime banimi Nj/A Laç dhe Nj/A Mamurras (Qendër)	30%* 0.05%	42.500	6
C.1.b	Ndërtesa për qëllime banimi Nj/A Mamurras (Fshatra)	30%* 0,040%	42.500	5
C.1.C	Ndërtesa për qëllime banimi Nj/A Milot dhe NJ/A Fushë-Kuqe	30%*0.05%	34.000	5
C.2.a	Ndërtesa për veprimtari ekonomike Nj/A Laç dhe NJ/A Mamurras (Qendër)	30%*0.2%	42.500	26
C.2.b	Ndërtesa për veprimtari ekonomike Nj/A Mamurras (Fshatra)	30%*0.2%	42.500	26
C.2.c	Ndërtesa për veprimtari ekonomike Nj/A Milot dhe NJ/A Fushë-Kuqe	30%*0.2%	34.000	20

Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme së Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit

për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitet administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale.

Në rast se konstatohet deklaram jo i saktë i sipërfaqes së ndërtesës në përdorim nga ana e subjektit, atëherë do të zbatohen procedurat e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar pikërisht neni 116.

Mënyra e pagesës

Për banesat private vjelja e taksës së ndërtesës të bëhet pranë **Njësive Administrative Vendore** për të garantuar administrimin e procesit të vlerësimit të bazës së taksës, llogaritjen e taksës dhe mbledhjen e saj në nivel maksimal, e pasqyruar kjo në regjistër përkatës.

Nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën që shërbejnë për banim, si dhe kategoritë dhe nënkategoritë sipas qëllimit të përdorimit të ndërtesës, zbatohen taksat për m² si më poshtë vijon.

Në mbështetje të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar me vendimin nr.132, date 07.03.2018 pika 3, propozojmë një rritje të nivelit të taksës deri në masën 18% për taksën mbi ndërtesën për tatimpaguesit e subjekteve private (bizneset), që janë nën juridiksion të Njësive Administrative Kurbin, për të katër Njësitet Administrative: të Laçit, Mamurrasit, Milotit dhe Fushë-Kuqes. Për nivelin e taksës së ndërtesës për banim në fshatrat nën juridiksion të Njësisë Administrative Mamurras, propozojmë uljen në masën

- 20 % të nivelit të taksës mbi ndërtesën, e cila bëhet e barabartë me nivelin e taksës për banesën, me Njësitë Milot dhe Fushë-Kuqe pikërisht në vlerën 17 lekë/m² në vit, pasqyruar kjo sipas tabelës më lart. Tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij ligji. Ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera që posedon taksapaguesi, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë. *(Ndryshuar me Ligj Nr. 181/2013, dt. 28.12.2013, neni 5. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 203, dt. 30.12.2013).*

Afatet e pagesës së taksës së ndërtesës

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Subjektet private (familjarët) taksën për banesën duhet ta shlyejnë deri me datën 30 Dhjetor 2025. Për të gjitha kategoritë e subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat, ky detyrim paguhet me një kësht vjetor. Afati i pagesës është data 30 Qershor 2025.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës së ndërtesës:

Përgjegjësit për vjeljen e taksës mbi ndërtesën (banesë) të subjekteve private janë:

- a. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë “Biznes”, struktura përgjegjëse është Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, e cila e kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës dhe kategorive në tabelën e cituar më lart. Detyrimi për taksën e ndërtesës është vjetor (jo me këste).
- b. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat e banimit për kategorinë “Familjarë” që ka kontratë me Sh.A. Ujësjellës-Kanalizime Kurbin, strukturë përgjegjëse është Ndërmarrja e Sh.A. Ujësjellës-Kanalizimeve Kurbin, ndërsa për ato familjarë që nuk kanë kontratë me Ndërmarrjen e Sh.A. Ujësjellës-Kanalizimeve Kurbin, strukturë përgjegjëse mbeten të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Kurbin në koordinim me Drejtorinë e Planifikimit të të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin.

I. 1.2 Taksa mbi tokën bujqësore

Baza e taksës

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Kjo taksë zbatohet sipas ligjit nr.9632 dt.30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore “, i ndryshuar. Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural . Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 1(vlera e taksës në lek / hektar në vit). që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime. Taksa e tokës bujqësore vazhdon me uljen prej 30 % të nivelit të taksës për çdo kategori të tokës bujqësore të vendosur me Vendim Këshilli Bashkiak, kjo bazuar në kopetencat që i jep Ligji nr. 9632. datë.30/10/2006, i ndryshuar, si dhe propozimit të Drejtorisë së Mjedisit dhe Bujqësisë pranë Bashkisë. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Njësia Laç II , Mamurras III, Milot III dhe Fushë-Kuqe III.

Kategoritë e tokës bujqësore	Lek/ha/vit 100%	Taksa në lek/ha/vit (me një zbritje prej 30%)
I	4200	2940
II	3500	2450
III	2800	1960
IV	2300	1610
V	1900	1330
VI	1600	1120
VII-X	1400	980

Struktura përgjegjëse për vjeljet e taksës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për të gjitha kategoritë janë Njësitë Administrative përkatëse në bashkëpunim dhe rakordim me Drejtorinë e Planifikimit të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Mjedisit në Bashkinë Kurbin. Bashkëpunimi rregullohet me rregullore (urdhër) të veçantë të miratuar nga Kryetaria e Bashkisë.

Ngarkohet Drejtoria e Mjedisit, konkretisht Sektori i Bujqësisë për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari për çdo fermë/fermer. Ngarkohet Sektori i Bujqësisë të saktësojë aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP) sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme dhe t’ia përcjellë këtë informacion Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore për përlllogaritjen e detyrimit mbi tokën bujqësore.

Mënyra e pagesës: Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data **31 Dhjetor 2025**.

Për pronat e njohura nga Komisioni i Kthimit të Pronave , sqarojmë se për personat që i zotërojnë këto prona aplikohet taksa sipas natyrës së pronës, nëse është tokë bujqësore trajtohen si të tilla, nëse janë pyje ose inproduktive, trajtohen sipas ligjeve në fuqi.

Përfundime

Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes, përjashtohen nga taksa për periudhën në fjalë.

I.1.3 Taksa mbi truallin

Baza e taksës

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. *Deklarata ka vlefshmëri 1 (një) vjeçare*. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ka detyrimin të verifikojë në terren me grupet e punës së kontrollot të terrenit (komision), saktësinë e vetë deklarimit të subjektit, jo më vonë se 10 ditë pas deklarimit. Në rast se konstatohet deklarim jo i saktë i sipërfaqes së truallit në përdorim nga ana e subjektit, atëherë do të zbatohen procedurat e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar pikërisht neni 116.

Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2, të ligjit 9632/2006, i ndryshuar.

Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë për të gjitha Njësitë Administrative:

Klasifikimi sipas përdorimit	Vlera minimale e taksës në lekë/m²/vit me ligj	Vlera e miratuar e taksës në lekë/m²/vit
Truall për biznes	18	20
Truall për banim	0.42	0.50

Mënyra e pagesës:

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të takspaguesit zyra e Planifikimit të të Ardhurave në Bashki duhet të njohin dokumentat e vërtetimit të pronësisë sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Zyra e regjistrimit të pasurisë jep të dhëna pa shpërblim Bashkisë për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre çdo 3 muaj për regjistrimet e reja dhe ndryshimet e gjendjes së pronave, neni 24 të ligjit nr.9632/2006, i ndryshuar.

Zyra e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bën regjistrim apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme ndërtese apo tokë bujqësore nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e Bashkisë i cili konfirmon pagesën e taksave respektive të legjislacioneve në fuqi.

Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet edhe me një këst. Afati i pagesës është data 30 Qershor i vitit fiskal, për subjektet fitimprurëse. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për të gjitha kategoritë e biznesit, është Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, Postës Shqiptare Sh.A, ose në arkën e Bashkisë brenda afatit të përcaktuar për vitin fiskal.

Çdo subjekt fitimprurës, duhet të paraqesë dokumentacionin e pronësisë ose vetëdeklarimin e sipërfaqes së truallit në pronësi, për të përlllogaritur vlerën e detyrimit vjetor. Në mungesë të dokumentacionit detyrimi vjetor i referohet sipërfaqes së ndërtesës të shfrytëzuar për aktivitetin fitimprurës.

Detyrimi për familjarët shlyhet si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga Ujësjellës Kanalizime Sh.A, në cilësinë e agjentit tatimor. Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin, faturohen direkt në çdo Nj/Administrative dhe rakordojnë, duke pasqyruar ndryshimet e herë pas herëshme dhe duke e përcjellë këtë informacion çdo fundmuaj në Drejtorinë e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin. Detyrimi për taksën mbi ndërtesën së bashku me tarifat e shërbimit është vjetor. Ky detyrim mund të paguhet me një këst ose i ndarë. Afati i shlyerjes së pagesës për detyrimin e taksës dhe tarifave familjare është data 30 Dhjetor.

Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme

sot ASHK. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet (deklaratë nga vetë individi) e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Pas deklarimit të bërë nga ana e subjektit, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave vendore , ka detyrimin të verifikojë në terren me grupet e punës saktësimin e vetë-deklarimit të subjektit, jo më vonë se 10 ditë pas deklarimit. Në raste të konstatimit të mosdeklarimit të saktë të sipërfaqes së truallit në përdorim nga ana e subjektit, atëherë do të zbatohen procedurat e Ligjit Nr.9920 Datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë , i ndryshuar”, neni 116.

Përjashtime nga pagesa e taksës:

Përjashtohen nga pagesa e taksës të gjitha familjet sipas ligjeve në fuqi.

I.2 Taksa e fjetjes në hotel

Me hotel kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimin hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim. Baza e taksës së fjetjes në hotel, është çmimi i fjetjes, për net fjetje në hotel.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Taksa llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së miratuar nga Këshilli Bashkiak, për net qëndrimi me nurin e netëve të qëndrimit në hotel. Kjo taksë bazohet në ligjin nr.9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar ku pasqyrohet në tabelën e mëposhtme.

Taksa e fjetjes në hotel	Vlera minimale e taksës në lek/natë që miratohet
Hotel 4-5 yje	105
Hotel nën katër yje, motel, bujtinë, hstel, si dhe çdo njesi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimit të ligjit për turizmin.	35

Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Bashkia, për natë qëndrimi

në hôtél. Pagesa kryhet brenda datës 5 të muajit pasardhës. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet çmimi dhe vlera e taksës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës së fjetjes në hotel

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore në Bashkinë Kurbin.

I.3 Taksë e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja .

Baza e taksës

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

1.Niveli i taksës në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë për Bashkinë Kurbin është në masën 4 (katër) për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerrë me akt nga Këshilli i Ministrave.

2. Niveli i taksës për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët (jo për qëllim shitje), të ndërtuara vetë individ apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë për Bashkinë Kurbin është vlera më e lartë mes 3 (tre) për qind e kostos mesatare të ndërtimit dhe 3% e vlerës së preventivit.

